




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odelenje za Opštu Upravu

Protokolli/Protokol/Protocol 11 Nr.

Nr. I prot. 4874 Me 18.10.2022
Br. prot. Dt. 18.10.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

Përgatitur më/Pripr. dana/Prepared at: 18.10.2022	
Për/Za/To:	Policinë e Kosovës, Rahovec Shoqatat e Gjahtarëve në Komunën e Rahovecit Autoriteti Pyjor Komunal - Rahovec
CC	Smajl Latifi, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From:	Berat Duraku, Drejtor i Drejtorisë për BPZHR-së
Lënda/Predmet/Subject:	NJOFTIM

Pas vendimit me nr. 3138 të datës 33.09.2022 të Ministrit të MBPZHR-së për hapjen e sezonit të gjetisë 2022-2023 ku në pikën 2 të këtij vendimi thuhet: **Sezoni i Gjetisë shpallet i hapur me 18 shtator**, më lejoni të ju njoftoj se në Komunën e Rahovecit nuk do të ketë hapje të sezonit të gjetisë.

Pas takimit të përbashkët me Inspektorët e Gjetisë dhe Pylltarisë në kuadër të MBPZHR-së vendosëm që të shtyhet hapja e sezonit të Gjetisë për vitin 2022-2023 deri në njoftim tjetër.

Duke u nisur nga fakti se lidhur me menaxhimin e vendgjahishtës së përbashkët "DAFINA", Komuna e Rahovecit pasi që ka kryer kontestin gjyqësor dhe në bazë të aktgjykimit të gjykatës, **nuk ka menaxhues të vendgjahishtës së përbashkët**, andaj është vendosur sikur në paragrafin 1 të këtij njoftimi.

Pas vlerësimit të situatës së krijuar në lidhje me menaxhimin e vend-gjahishtës së përbashkët dhe hapjen e sezonit të gjetisë në territorin e Komunës së Rahovecit, **NJOFTOHEN** të gjithë palët e interesuar dhe subjektet me përgjegjësi ligjore se:

Sipas Ligjit për Gjetinë Nr. 02/L-053, Neni 8, paragrafi 2, 3, dhe 4, shpallja e hapjes së sezonit të gjetisë është kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural dhe assesi e Shoqatave të Gjahtarëve.

Kërkojmë nga të gjithë Gjahtarët që veprojnë në territorin e Komunës së Rahovecit që të vetëpërmbahen dhe të respektojnë rregullativat ligjore në fuqi, përndryshe do të jenë subjekt i shkeljeve të dispozitave ligjore për gjueti ilegale.

Kërkojmë nga organet e rendit – Policisë së Republikës së Kosovës, Autoriteti Pyjor i Komunës si dhe inspektorët për Pylltari dhe Gjueti, të ndërmarrin të gjitha veprimet të domosdoshme për të siguruar respektimin e rregullativës në fuqi.

Me respekt,